

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL
PËR MARRJEN E KATEGORIVE
TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE
TË “ARSIMIT SPECIAL”**



Program orientues

**Koordinator:
Albana Markja**

2025-2026




TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES.....	1
HYRJE	2
QËLLIMI I PROGRAMIT	4
PËRMBAJTJA E PROGRAMIT.....	6
Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar	6
Modele të pyetjeve për secilin nivel arsimor AMU dhe për AML	13
Përmbajtja e programit orientues për orën mësimore të hapur	19
Model ore mësimore për secilin nivel AMU dhe AML	20
Kriteret e vlerësimit të orës mësimore.....	27
Përmbajtja e programit orientues për projektin kurrikular	34
Modele të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU dhe AML	36
Kriteret e vlerësimit të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU dhe AML	44


HYRJE

Me reformimin e sistemit arsimor, roli i mësuesit ka pësuar një transformim të ndjeshëm për t'iu përgjigjur kërkesave të shoqërisë dhe nevojave të nxënësve. Ai pritet të jetë një edukator që krijon një mjedis të hapur dhe mbështetës për të gjithë nxënësit, pavarësisht prejardhjes, aftësive apo nevojave të tyre specifike. Ai përshtat metoda të ndryshme pedagogjike për të siguruar që secili nxënës të ketë mundësi të barabarta për të mësuar dhe për të marrë pjesë në aktivitetet shkollore.

Profili i një mësuesi ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollën e sotme karakterizohet nga një kombinim i fortë i empatisë, njohurive profesionale dhe aftësive për përshtatje. Ky mësues ka për detyrë të ofrojë mbështetje të drejtpërdrejtë për nxënësit me aftësi të kufizuara, duke krijuar një mjedis të sigurt dhe përfshirës. Ai duhet të jetë i aftë të identifikojë sfidat individuale të secilit nxënës dhe të përdorë metoda të personalizuara për t'ua lehtësuar procesin e të nxënës. Gjithashtu, mësuesi ndihmës duhet të ketë një njohuri të thellë të strategjive për mbështetjen e zhvillimit të aftësive të nxënësve me kufizime fizike, mendore ose zhvillimore, duke siguruar që ata të përfshihen aktivisht në aktivitetet mësimore dhe sociale.

Përveç përgatitjes akademike, ky mësues duhet të bashkëpunojë ngushtë me mësuesit e klasës, prindërit dhe profesionistët e tjerë për të krijuar dhe zbatuar plane të individualizuara që përmbushin nevojat specifike të nxënësve. Roli i tij nuk kufizohet vetëm në ndihmën akademike, por edhe në mbështetjen emocionale dhe zhvillimin e aftësive sociale të fëmijëve.

Përfshirja e mësuesit ndihmës në testim dhe vlerësim profesional është thelbësore për avancimin e tij në karrierë, pasi kjo jo vetëm që mat performancën dhe efektivitetin e tij në mbështetjen e nxënësve me aftësi të kufizuara, por edhe i ofron mundësi për zhvillim të vazhdueshëm profesional. Procesi i testimit ndihmon në vlerësimin e njohurive dhe aftësive që mësuesi ka për të adresuar nevojat e veçanta të nxënësve, duke siguruar që ai të jetë në përputhje me standardet profesionale të synuara. Për më tepër, ky proces i lejon mësuesit ndihmës të përfitojë dhe të rritet profesionalisht, duke e përgatitur më mirë për sfidat që has në klasë dhe për një karrierë më të avancuar në fushën e arsimit gjithëpërfshirës.



Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MAS-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen:

- për kandidatët e kategorisë “Mësues i kualifikuar”, procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve, vlerësimit që realizohet nëpërmjet orës mësimore të hapur dhe vlerësimit me test të informatizuar sipas lëndëve/profileve dhe niveleve përkatëse;
- për kandidatët e kategorisë “Mësues specialist”, procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve, vlerësimit që realizohet nëpërmjet orës mësimore të hapur dhe vlerësimit që realizohet nëpërmjet projektit kurrikular në lëndën/profilin dhe nivelin përkatës;
- për kandidatët e kategorisë “Mësues mjeshtër”, procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve dhe vlerësimit që realizohet nëpërmjet projektit kurrikular në lëndën/profilin dhe nivelin përkatës.

QËLLIMI I PROGRAMIT


Programi i zhvillimit profesional për marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve ndihmës të arsimit special është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për t'u ardhur në ndihmë:

- të gjithë mësuesve të arsimit special në zhvillimin e tyre profesional dhe për marrjen e kategorive të kualifikimit.
- të gjitha Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është i detyruar dhe i unifikuar, për mësuesit që do të marrin kategoritë e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje cilësore, për të përballuar me sukses kërkesat që ka ky proces kombëtar.

Programi ka për qëllim që mësuesi:

- të njohë dhe të zbatojë rrishtë më të fundit në sistemin arsimor parauniversitar;
- të zotërojë kompetencat, bazuar në standardet profesionale të mësuesit, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie të suksesshme;
- të demonstrojë aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e mjedisit të klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorin e metodave dhe veprimtarive sipas stileve të të nxënësve; për përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve etj.;
- të tregojë përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë dhe në jetën reale, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- të njohë konceptin e gjithëpërfshirjes dhe të demonstrojë përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor dhe në aktivitetet e shkollës;
- të lidhë dhe të aktualizojë konceptet lëndore me prioritet globale që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike, fatkeqësitë natyrore, pandemitë, krizat ekonomike, antisemitizmin,



çështjet e barazisë gjinore etj., me qëllim ndërgjegjësimin e nxënësve dhe përgatitjen e tyre për të përballuar sfidat e shoqërisë sot dhe në të ardhmen;

- të demonstrojë zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- të zotërojnë zbatimin e rregullave drejtshkrimore të gjuhës shqipe gjatë procesit të mësimdhënie – nxënies;
- të përdorë aftësitë e TIK-ut në procesin mësimor, si një nga risitë më të fundit në mësimdhënien me kompetenca dhe modelet e arsimit të kombinuar;
- të planifikojë dhe të zhvillojë orë mësimi efektive sipas metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të të nxënit.

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Përmbajtja e programit orientues të kualifikimit të mësuesve është e organizuar në tre kapituj, si më poshtë:

3.1 Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar. Në këtë rubrikë përfshihen kompetencat profesionale dhe rezultateve e pritshme sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional për realizimin e testit të informatizuar, si edhe modele të pyetjeve për arsimin special në arsimin parauniversitar.

3.2 Përmbajtja e programit orientues për orën mësimore të hapur. Në këtë rubrikë përfshihen kompetencat profesionale për organizimin e orës së hapur mësimore, tre modele orësh mësimore për arsimin special, si dhe kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur.

3.3 Përmbajtja e programit orientues për projektin kurrikular. Në këtë rubrikë përfshihen kompetencat profesionale për zhvillimin e projektit kurrikular, dy modele projekti kurrikular për arsimin special në arsimin parauniversitar, si dhe kriteret e vlerësimit të projektit kurrikular.

Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar

Testi i informatizuar i vlerësimit të kualifikimit përbëhet nga dy pjesë:

- a) Pjesa e parë përmban, zbatimin e programeve përkatëse lëndore dhe planifikimin e lëndës, mjedisin e të nxënit, metodologjitë efektive të mësimdhënie - nxënies në përgjithësi dhe të lëndës përkatëse, vlerësimin dhe arritjet e nxënësve, aspekte të etikës dhe komunikimit të mësuesit në institucionin arsimor parauniversitar në mjediset e institucionit, si dhe aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- b) Pjesa e dytë përfshin aspekte të zbatimit të përmbajtjes shkencore të lëndës në situata praktike nga jeta reale.

Programi i testimit të informatizuar është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- programe lëndore të lëndëve;
- aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në procesin mësimdhënie – nxënie të arsimit special;
- aspekte të etikës dhe të komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtja shkencore e fushës së arsimit special, sipas fushave të zhvillimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Në fushat kryesore të zhvillimit profesional përcaktohen:

- kompetencat profesionale si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave;
- literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushës.

Përshkallëzimi i njohurive dhe i aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë të testimit, do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

FUSHA “PROGRAME LËNDORE TË ARSIMIT SPECIAL”	
Kompetenca	
“Zbatimi në mënyrë efektive i programeve lëndore për arsimin special në shkollë”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i arsimit special:</i> • zbaton programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij; • përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim; • përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programit;	• Korniza kurrikulare, 2014. • Kurrikula bërthamë AMU, klasat VI-IX, 2014. • Programet aktuale lëndore të arsimit fillor. • Literaturë që ka në fokus sindroma të ndryshme si autizëm, DOWN, prapambetje mendore, çrregullime të sjelljes,

• gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program; • harton plane edukative individuale (PEI) në përgjigje të aftësive dhe nevojave specifike të fëmijës; • harton rezultate të nxëni për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, në përputhje me rezultatet/objektivat e programit (PEI); • kategorizon rezultatet e të nxënit e programit sipas niveleve të arritjes së të nxënit; • tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të arsimit special); • përzgjedh mjetet mësimore të personalizuar, të nevojshme për të realizuar përmbushjen e PEI-it.	hiperaktivitet etj.
---	---------------------

FUSHA “ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-ut NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE”

Kompetenca I

“Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien në arsimin special”

Literatura e rekomanduar

Rezultatet e pritshme

Mësuesi i arsimit special:

- demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij;
- përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve;

- Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS.
- Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët.
- Literaturë që ka në fokus sindroma të ndryshme si autizëm, DOWN,

- demonstron respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit; - identifikon nevojat specifike të nxënësve; - planifikon punën afatshkurtër dhe afatgjatë me secilin nxënë; - demonstron qëndrim pozitiv ndaj procesit të të nxënit; - motivon nxënësit duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre; - krijon klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit; - punon me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit.	prapambetje mendore, çrregullime te sjelljes, hiperaktivitet etj.
--	--

Kompetenca II

“Përdorimi i metodave dhe strategjive efektive në mësimdhënie në arsimin special”

Literatura e rekomanduar

Rezultatet e pritshme

Mësuesi i arsimit special:

- përdor metoda të ndryshme në përputhje me sindromën që shfaqin fëmijët me aftësi të kufizuar;
- përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një rezultati të caktuar;
- përdor metoda e teknika që i aftësojnë nxënësit në jetën e përditshme;
- respekton parimet bazë të edukimit special;

- Nivelet e arritjes (arsimi bazë), IZHA 2016.
- Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”.
- Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017.
- Urdhër nr.29 datë 20.01.2023 “Për miratimin e standardeve profesionale të mësuesve ndihmës në arsimin parauniversitar”.
- Material ndihmës për mësuesit lidhur me përdorimin e platformave

• planifikon një orë mësimore apo veprimtari mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin; • përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen; • demonstroi teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit; • harton fisha për vlerësimin e nxënësit sipas fushave të zhvillimit; • demonstroi teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit; • shpjegon parimet e hartimit të një testi për nxënësit me aftësi të kufizuara. • përdor programe kompjuterike në ndihmë të realizimit të rezultateve të të nxënësit.	online në procesin mësimor, ASCAP 2021. • Literaturë që ka në fokus aspekte të mësimdhënies dhe nxënies me nxënësit me sindroma të ndryshme si autizëm, DOWN, prapambetje mendore, çrregullime të sjelljes, hiperaktivitet etj.
---	--

FUSHA “ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT”	
Kompetenca	Literatura
“Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”	
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i arsimit special:</i> • njeh rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin;	• Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar. • Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhër nr.31, datë 28.01.2020

• sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.	• Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”
--	---

FUSHA “ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE”	
Kompetenca	Literatura
“Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe”	
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i arsimit special:</i> • njeh rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe; • demonstroi zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor.	• Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.

FUSHA “PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS”

Kompetenca

“Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënie në arsimin special”

Literatura e rekomanduar

Mësuesi i arsimit special:

- Shpjegon konceptet kryesore që lidhen me fushën e arsimit special dhe llojet e paaftësive intelektuale;
- shpjegon konceptet kryesore me të cilat operon mësimdhënia dhe nxënia në arsimin special;
- demonstroi veprimtari me nxënësit me qëllim aftësimin e tyre në lidhje me veprimtaritë e jetës së përditshme;
- shpjegon dhe interpreton parimet dhe konceptet në lidhje me zhvillimin e tyre në fushën konjitive, sociale, motorike, të komunikimit dhe autonomisë personale;
- demonstroi krijimin dhe përdorimin e materialeve didaktike në mbështetje të të nxënës të fëmijës;
- tregon përmes shembujve përshkallëzimin e veprimtarive për të arritur përvetësimin nga nxënësit të koncepteve dhe shprehive;
- përdor veprimtari të ndryshme në përputhje me sindromën që shfaqin fëmijët me aftësi të kufizuar.

- Literaturë që ka në fokus njohuri dhe informacion rreth sindromave të ndryshme si autizëm, DOWN, prapambetjen mendore, çrregullime të sjelljes, hiperaktivitet etj.
- Literaturë që ofron informacion dhe shembuj konkretë të punës me fëmijët me sindroma të ndryshme.

Modele të pyetjeve për secilin nivel arsimor AMU dhe për AML

Model pyetjesh të “Arsimit Special”

A) Programi lëndor

Pyetja 1

Zhvillimi i kompetencës “Të shkruarit për qëllime personale e funksionale” arrihet nëpërmjet veprimtarive si:

- A) Kopjim i teksteve me 2-4 fjali.
- B) Përdorimi i shkronjës së madhe.
- C) Formimi i fjalive me fjalët e dhëna.
- D) Shkrimi i një kartoline urimi nënës.

Pyetja 2


Synimi i programit në lëndën e leximit është:

- A) Nxënësit të lexojnë, të shkruajnë e të shprehen në gjuhën shqipe.
- B) Nxënësit të njohin shkronjat e t'i lidhin ato në fjalë.
- C) Nxënësit të lexojnë tregime të ndryshme.
- D) Nxënësit të shprehen në gjuhën e shkruar.

Pyetja 3

Mësuesi ndihmës ka për detyrë të:

- A) punojë me nxënësin me aftësi të kufizuara në klasë.
- B) punojë me nxënësit e tjerë.
- C) japë mësim në orët e djathtësive.
- D) ndihmojë nxënësin me aftësi të kufizuara në shtëpi.



B) Aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë

Pyetja 4

Për menaxhimin e sjelljes së papërshtatshme të FAK mësuesi i klasës:

- A) Përfshihet në zgjidhjen e situatës së bashku me mësuesen ndihmëse.
- B) Menaxhon klasën duke mos u përfshirë në problemet e FAK.
- C) Raporton në drejtori për problematikat që i paraqiten në klasë.
- D) Komunikon me prindin e FAK për shqetësimin që paraqet fëmija në klasë.

Pyetja 5


Procesi mësimor për realizimin e temës ”Zhveshja e xhupit” realizohet në:

- A) dy etapa.
- B) sa etapa të jetë e nevojshme.
- C) pesë etapa.
- D) varësi të kushteve.

Pyetja 6

Mësuesi ndihmës që ka një nxënës që nuk dëgjon NUK duhet:

- A) të qëndrojë më afër se 1.8m distancë me nxënësin;
- B) të lëvizë përreth gjatë kohës që flet;
- C) ta përsërisë shpjegimin nëse nxënësi nuk e ka kuptuar;
- D) të shoqërojë me gjeste atë që thotë.



Pyetja 7

Të vlerësosh nxënësin me afti të kufizuara për rezultatet e arritura është:

- A) përmbushja e kompetencave të detyrës së dhënë;
- B) zbatim i detyrueshëm i procedurës;
- C) procedura që përdoret për të marrë informacion rreth performancës së nxënësit;
- D) kontribut i një detyre në arritjen e qëllimit.

C) Aspekte të komunikimit dhe etikës

Pyetja 8


Një klasë gjithëpërfshirëse është ajo ku:

- A) vlerësimet përsëriten derisa çdo nxënës të arrijë rezultatet minimale;
- B) mësuesit japin mësim duke iu referuar vetëm tekstit mësimor për të pakësuar ngarkesën e nxënësve;
- C) ka një përfshirje aktive të nxënësve me rezultate të larta;
- D) mësuesit krijojnë për çdo nxënës praktika dhe përvoja të ndryshme të nxëni.

Pyetja 9

Kodi i etikës është hartuar për të ndihmuar mësuesin të marrë vendimet e duhura:

- A) për çdo problem me të cilin përballlet;
- B) në rastet e dilemave etike;
- C) në situatat e zakonshme;
- D) në situatat jo të zakonshme.



D) Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe

Pyetja 10

Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

- A) Temperatura në det e në tokë është e ndryshme.
- B) Temperatura në Det e në Tokë është e ndryshme.
- C) Temperatura në det e në Tokë është e ndryshme.
- D) Temperatura në Det e në tokë është e ndryshme.

Pyetja 11

Qarkoni alternativën ku fjala është shkruar saktë.


- A) Institucion arsimor
- B) Institucionë arsimorë
- C) Institucion arsimor
- D) Institucion arsimor

E) Përmbajtja shkencore e lëndës

Pyetja 12

Fëmija me Disortografi:

- A) shkruan mesazhe të shkurtra
- B) organizon fletën e shkrimit.
- C) bën gabime drejtshkrimore.
- D) kopjon saktë fjalë e fjali.



Pyetja 13

Qarkoni kur konsiderohet i gjithëpërfshirë nxënësi me aftësi të kufizuara gjatë një ore mësimi?

- A) Kur punon në grup me nxënës të tjerë për një projekt.
- B) Kur mësuesi i ka dhënë një detyrë sipas PEI.
- C) Kur FAK zgjidh detyrën i ndihmuar nga mësuesi ndihmës.
- D) Kur nxënës të caktuar nga mësuesja e ndihmojnë të bëjë detyrën.

Pyetja 14

Fëmijët në klasën parashkollore shkruajnë:

- A) me shkrim dore;
- B) me shkrim shtypi dhe dore;
- C) me shkrim shtypi;
- D) nuk ushtrohen në shkrim.

Pyetja 15


Paaftësia në të nxënë mund të ndodhë për të gjithë arsyet e mëposhtme me përjashtim të:

- A) keqfunksionimit cerebral;
- B) çrregullimeve emocionale;
- C) shqetësimeve sjellore;
- D) faktorëve kulturorë.

Pyetja 16

Qarko një simptomë që shpreh dëmtimet në fushën e komunikimit te fëmijët me autizëm:

- A) Ekolalia.
- B) Aftësia për të ndjekur bisedën.
- C) Përqendrim i shkurtër.
- D) Lojëra me rreshtime.



Pyetja 17

Qarko veçorinë që ka një fëmijë me ADHD:

- A) Të dëgjon kur i flet në mënyrë direkte.
- B) I kryen porositë me pak nxitje.
- C) Vështirësi për të qenë i përqendruar në një detyrë.
- D) Ndjek instruksionet që i jepen dhe arrin të përfundojë detyrat.

Pyetja 18

Një ambient i përshtatshëm mësimor për fëmijët e spektrit autik është:

- A) Ambient jo i strukturuar.
- B) Ambient i strukturuar sipas nevojave të fëmijës.
- C) Ambient me shumë mjete e ngjyra.
- D) Ambient me muzikë.

Pyetja 19

Fëmijët disleksikë **NUK** karakterizohen nga:

- A) intonacioni i duhur;
- B) marrja e paktë e informacionit nga ajo që lexojnë;
- C) ngatërrimi i shkronjave të ngjashme si “p,d”;
- D) leximi me vështirësi e jo i kuptueshëm.

Pyetja 20

Fëmija me aftësi të kufizuar tregon aftësi për jetën e përditshme kur:

- A) lexon korrekt;
- B) luan me shokët;
- C) përgatit sallatën;
- D) identifikon objektet e emërtuara.

Pyetja 21

Empatia ka të bëjë me:

- A) reagim emocional të fuqishëm;
- B) ndjenjat e mia ndryshojnë nga ndjenjat e personit tjetër;
- C) ndjenjat e mia janë njësoj si të të tjerëve;
- D) aftësinë për të ndjerë emocionet si i ndjen personi tjetër.

Përmbajtja e programit orientues për orën mësimore të hapur

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve praktike etj. Përpos kësaj, që nxënësit të zotërojnë kompetencat, duhet të përvetësojnë konceptet dhe të zotërojnë shprehitë. Të dyja këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies gjatë orës mësimore, të cilat përmbushin rezultatet e të nxënësve dhe përshtaten me stilet e të nxënësve dhe nevojat e nxënësve.

Një mësimdhënie - nxënie e mirë menduar dhe e mirë planifikuar, si dhe një mjedis të nxënësve efektiv krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësve. Kompetencat janë të ndërlidhura dhe zhvillohen në vazhdimësi nëpërmjet situatave të të nxënësve që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Nxënësit janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, ndërtime ose simulime të njohurive dhe të aftësive, si dhe në krahasime rezultatesh apo nxjerrje konkluzionesh. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një mjedis dhe atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre.

Më poshtë janë paraqitur tre modele orësh mësimore që përcjellin shembuj të veprimtarive që zhvillohen me nxënësit me aftësi të kufizuara në klasën ku mësuesi është përfshirë si dhe kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur përmban model ore mësimore si dhe kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur.

Model ore mësimore për secilin nivel AMU dhe AML

Mësuesit janë të lirë të përzgjedhin vetë temën, klasën, metodat, teknikat, mjetet, veprimtaritë sipas stileve të të nxënës, instrumentet e vlerësimit etj., që do të përdorin gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur.

A) Model 1 ore mësimore në arsimin special

Emri i nxënësit XXXXXXXX

Klasa III

Fusha/Lënda: Gjuhë dhe komunikim/ Gjuhë shqipe

Tema: Frutat e dimrit

Rezultatet e pritshme:

Nxënësi:

- tregon me gisht tre fruta të emërtuara;
- realizon lojë simbolike “kukulla dhe arra”.

Mjetet: Album, fishë me figura frutash, fruta te freskëta (arra, gështenja, portokall, limon, mollë) në qese; fletë për ngjyrosje me model, lapsa me ngjyra, kukull.

Metodologjia: Demonstrim, konkretizimin, loja.

Lidhja me lëndë/fusha të tjera: art figurativ/motorikë fine

Organizimi i orës së mësim:

- Përshëndetja me shokët, mësuesen.
- Lojë “Çfarë kemi në qese?” mbi bankë kemi vendosur figurat e frutave. Nxënësi fut dorën

në qese dhe tregon me gisht figurën e frutit që kapi mësuesja/ ose ai vetë.

- Mësuesja emërton dhe bashkë me nxënësin prekin frutat ose i tregojnë me gisht në figurë.
- Ftohet nxënësi të lidhë figurën me frutin.
- Gjej në album: makina, fëmija, dera, molla, pema, arra etj.
- Mësuesja tregon historinë e vajzës së vogël që i pëlqenin shumë gështenjat e fton nxënësin të luajnë së bashku ku insiston tek mënyra si ai duhet të kërkojë diçka që dëshiron, si kënaqet dhe bën sikur e ha frutin.
- Zgjidh një figurë dhe ngjyrose. Gjatë ngjyrosjes mësuesja shoqëron me fjalë aktivitetin si emërton ngjyrën që ka zgjedhur nxënësi, e lavdëron që po ngjyros brenda kontureve apo veprime të tjera që nxënësi bën.
- Gjatë gjithë aktiviteteve nxënësi vlerësohet me vështirime dashamirëse, shprehje si: “të lumtë, bravo, sa bukur” etj.

Vlerësimi:

XXXXXX dallon shumë mirë mollën, portokallin, dhe disi gështenjën. Ai ishte më aktiv dhe shprehu kënaqësi sidomos tek loja me qese. Ai ka filluar të ngjyrosë brenda figurës dhe po ndjek udhëzimet e mësueses sidomos kur ka të bëjë me veprime konkrete. Tek loja simbolike imitoi bukur sikur po e hante gështenjën, por e ka akoma të vështirë të kërkojë në mënyrën e duhur çfarë dëshiron.

Detyra shtëpie:

Të vendosë në frutierë frutat që i emërton prindi tre herë dhe me shpejtësi (në formë loje me vëllain).

B) Model 2 ore mësimore në arsimin special

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi

Lënda: Gjuhë shqipe

Klasa: VIII-të

Tema mësimore: Përralla dhe fabula

Kompetencat:

- Të dëgjuarit
- Komunikimi dhe të shprehurit

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.

Nxënësi:

- dëgjon për një qëllim të caktuar përrallën.
- përgjigjet rreth pyetjeve të përmbajtjes
- ritregon përrallën

Fjalë kyç : përrallë, figura.

Burimet: Teksti mësimor, CD (youtube), libra me përralla dhe fabula nga Ezopi, LA Fonteni.

Lidhja me fushat e tjera dhe me temat ndërkurrikulare: Biologji, Qytetari, Arte, TIK, Teatër.

Metodologjia: diskutim, pyetje-përgjigje, punë e drejtuar

Organizimi i mësimit për realizimin e temës

Hapi parë

Mësuesja lexon përrallën, ose vendos CD me filmin vizatimor. Mësuesi mund të përdorë një nga variantet e sugjeruara

- Dhelpra dhe Lejleku dy gosti (Film vizatimor shqiptar, 10 minuta 17 sekonda)
- Përrallë për fëmijë - Dhelpra dhe Lejleku (Tregim i përrallës shoqëruar me vizatime, 3 minuta e 20 sekonda)

Se cilën do të përdorë nga variantet e mësipërme e zgjedh mësuesi duke e përshtatur me aftësinë e nxënësit

Hapi dytë

Bisedë: Ndhimojmë bisedën më pyetjet:

- Çfarë ndodhi në përrallë, ose film?
- Emërtoi figurat (personazhet) dhelpra dhe lejleku
- Çfarë vështirësie kishte lejleku?
- E përshkruajmë lejlekun. Lejleku është shpend me pendë të bardha, sqep, qafë dhe këmbë të gjata. Po dhelpra çfarë ngjyre e ka trupin? Bishti i saj është i gjatë apo i shkurtër?
- Si veprroi dhelpra me lejlekun?
- Si u ndje lejleku? Me këtë pyetje nxit mundësinë për të treguar vlerat që mbartin personat me aftësi ndryshe në komunitetin e klasës, shkollës etj.

-
-

Hapi tretë

Vizato lejlekun dhe dhelprën sipas rubrikës(😊; ☹️) ose të shkruaj emrat(sipas aftësisë së nxënësit)

😊 _____



Mesazhi i përrallës që mësuesja do të punojë me nxënësin

Nuk do të lejojmë askënd të na mërzi, duhet të tregojmë mundësitë dhe aftësitë që mbartim.

Reagimet

(Në këtë rubrikë shënojmë me kujdes reagimet e nxënësit gjatë dëgjimit të përrallës, ose gjatë shikimit të filmit vizatimor (përqendrimi në minuta)

Cilin personazh vendos tek rubrika 😊, 😞 etj.

C) Model 3 ore mësimore në arsimin special

Klasa III

Lënda: Matematikë

Tema e mësimit: Një më shumë, një më pak. *(Orën e parë mund të zhvillohen vetëm veprimtari me objekte kurse orën e dytë vazhdohet me tekstin mësimor).*

Rezultatet e të nxëniet të kompetencave sipas temës mësimore:

Nxënësi:

- gjen një më shumë ose një më pak se një numër i dhënë.
- demonstroi besim në forcat vetjake.
- respekton përpjekjet personale dhe ato në grup.

Fjalët kyçe: 1 më shumë, 1 më pak.

Burimet: Libri i matematikës, tabela e numrave, kube dhe mjete ndihmëse.

PËRSHKRIMI I VEPRIMTARISË MËSIMORE

Ora 1

➤ **Hapi i parë:** Paraqitni objekte të ndryshme ndihmës si kub, lapsa .

Drejtohen pyetjet. Sa kub kemi në tavolinë? Nëse heqim 1 kub, sa kub na mbeten? Po nëse shtojmë 1 ose 2, sa do bëhet numri?

➤ **Hapi i dytë:** Përsëritet dhe me objekt të tjera i njëjti ushtrim.

➤ **Hapi i tretë:** Punë praktik në dysh. Njëri nxënës do të jetë numri 1 dhe tjetri do të jetë numri 2. Nxënësi me numrin 1 shkruan një numër dhe nxënësi numër 2 gjen numrin që është 1 më shumë se numri i shokut. Përsëritet disa herë, ndërrohen rolet për të gjetur 1 më pak se numri

i dhënë.

Ora 2

- **Hapi i parë:** Punë individuale me nxitje. Punon me nxitje për plotësimin e detyrës si duhet në tekst.
- **Hapi i dytë:** Plotëso, 3,...5.....7.....,.....10

Plotëso, 9,.....,7.....,5.....,3.....,2.....

- **Hapi i tretë:** Punë në grupe. Njëri grup thotë një numër, grupi tjetër tregon numrin pasues. Grupi tjetër tregon numrin dhe grupi tjetër tregon një numër më pak se numri i thënë.

VLERËSIMI MBI ARRITJEN E NXËNËSIT

Gjetjen e një më shumë, një më pak, se një numër i dhënë. Përfshirja dhe aktivizimi në grup.

Puna e pavarur,

DETYRË SHTEPIE: Plotëso fletoren e punës. Detyra të veçanta sipas nivelit të nxënësve.

Kriteret e vlerësimit të orës mësimore

Kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur:

- mbështesin mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit për të planifikuar dhe për të organizuar një orë mësimore sa më cilësore dhe efektive për arritjet e nxënësit;
- i shërbejnë drejtuesit dhe anëtarëve të rrjetit profesional, drejtuesit të shkollës si dhe pjesëmarrësve të tjerë gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur për të gjykuar dhe vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e kësaj ore mësimore;

Zhvillimi i orës së hapur mësimore, diskutimet, komentet, vlerësimet, sugjerimet e kolegëve u krijojnë mundësi të gjithë mësuesve të shkëmbejnë përvoja pozitive dhe të identifikojnë anët pozitive të një ore mësimore cilësore për t'i bërë pjesë të punës së tyre të përditshme.

Kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur

Kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur				
Gjithsej 30 pikë				
Përshkruesit	Niveli 1 - Dobët	Niveli 2 – Mjaftueshëm	Niveli 3 – Mirë	Niveli 4 – Shumë mirë
Planifikimi i orës mësimore të hapur (6 pikë)				
	0 pikë	1 pikë	2 pikë	3 pikë
Mësuesi ka planifikuar të	Mësuesi ka planifikuar orën mësimore pa pasur një koherencë të komponentëve. Rezultatet e të nxënësit (RN) nuk	Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënësit sipas programit lëndor; ka planifikuar situatë të nxënës, e cila nuk ndikon	Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënësit sipas programit lëndor; ka planifikuar situatë të nxënës, si dhe ka planifikuar	Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënësit sipas programit lëndor; ka planifikuar situatë të nxënës të cilën e ka përdorur

gjithë komponentët e orës së mësimi në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të të nxëniti	<i>bazohen në programin lëndor dhe mësuesi nuk ka planifikuar situatë të nxëni. Metodologjia është tradicionale dhe për më tepër nuk lidhet me stilet e të nxëni. Pyetjet që u drejtohen nxënësve nuk janë sipas niveleve.</i>	<i>shumë në përmbushjen e rezultateve të të nxëni (RN) ose nuk ka planifikuar situatë të nxëni. Organizimi i nxënësve në klasë është tradicional dhe nuk janë lidhur me stilet e të nxëni, Pyetjet në përgjithësi janë sipas niveleve.</i>	<i>organizimin e nxënësve. Metodat dhe teknikat mësimore janë në në koherencë me RN, por nuk përputhen me situatën e të nxëni dhe me stilet e të nxëni. Mësuesi ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.</i>	<i>si pjesë e metodologjisë së mësimdhënies, ka planifikuar organizimin e nxënësve dhe metodologjinë në koherencë me RN dhe me stilet e të nxëni, si dhe ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.</i>
Mësuesi ka planifikuar për temën mësimore qasje të reja inovative që lidhen me demonstrimin e kompetencave të të nxëni gjatë gjithë	<i>Mësuesi nuk planifikon duke përfshirë qasje të reja inovative dhe zhvillimin e kompetencave kyç të të nxëni gjatë gjithë jetës.</i>	<i>Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje më së shumti tradicionale. Metodat e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxëni gjatë gjithë jetës.</i>	<i>Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin e TIK dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Nga ana tjetër metodat e planifikuara</i>	<i>Mësuesi në planifikimin e tij kujdeset që të planifikojë qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin TIK dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Gjithashtu ai</i>

jetës, krahas kompetencave lëndore			<i>fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të nxënit gjatë gjithë jetës.</i>	<i>kujdeset që nëpërmjet metodave të planifikuara të përfshijë edhe rezultate të kompetencave kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.</i>
Mjedisi i të nxënit (6 pikë)				
Mësuesi ka krijuar një klimë pozitive, ku nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri -tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe.	<i>Mësuesi krijon një mjedis jo miqësor në klasë, ku jo të gjithë nxënësit kanë mundësi për t'u shprehur lirshëm. Gjatë orës së mësimit vetëm disa nxënës përfshihen në veprimtaritë e orës së mësimit për të shprehur mendimet e tyre.</i>	<i>Mësuesi krijon një mjedis tradicional në klasë, ku nxënësit nuk kanë shumë komunikim me njëri-tjetrin. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxëni, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i>	<i>Mësuesi kujdeset që nxënësit të respektojnë njëri-tjetrin dhe të jenë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxëni, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i>	<i>Mësuesi promovon suksesin e çdo nxënësi duke krijuar një klimë pozitive dhe mjedis miqësor, ku të gjithë respektojnë njëri-tjetrin dhe janë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxëni për të gjithë duke nxitur besimin dhe vlerësimin për veten.</i>
	<i>Mësuesi organizon orën e mësimit në</i>	<i>Mësuesi organizon orën e mësimit në</i>	<i>Mësuesi organizon orën e mësimit duke u kujdesur që</i>	<i>Mësuesi organizon orën e mësimit duke u kujdesur që</i>

Mësuesi angazhon dhe përfshin të gjithë nxënësit duke i nxitur dhe motivuar të ndërmarrin iniciativa, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.	<i>mënyrë tradicionale, ku pak nxënës përfshihen. Vetëm disa nxënës nxiten të marrin pjesë në mësim, të tjerët nuk nxiten me detyra motivuese. Mësuesi nuk u kushton vëmendje të gjithëve lidhur me pyetjet që ata i drejtojnë gjatë orës së mësimi.</i>	<i>mënyrë tradicionale, ku jo gjithë nxënësit përfshihen dhe angazhohen. Vetëm disa nxënës nxiten të marrin pjesë në mësim dhe të ndërmarrin iniciativa. Ai u kushton vëmendje, por nuk i jep mundësi të gjithëve të marrin një përgjigje.</i>	<i>të gjithë nxënësit të përfshihen dhe angazhohen, por nuk i nxit ata me detyra motivuese duke i lënë disi pasivë. Ai i kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje, por nuk u jep mundësi të gjithëve të marrin një përgjigje.</i>	<i>të gjithë nxënësit të përfshihen dhe angazhohen me detyra motivuese dhe i nxit ata të ndërmarrin iniciativa. Ai i kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.</i>
--	--	--	--	---

Metodat mësimore (6 pikë)

Mësuesi përdor metoda që nxisin mendimin kritik, krijues, që nxisin diskutimin (apo debatin), si dhe mendimin ndryshe.	<i>Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri në përdorimin e metodave të ndryshme gjatë orës së mësimi duke u fokusuar më shumti vetëm te ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës mësimore mësimi fokusohet</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për metoda të ndryshme gjatë orës së mësimi duke u fokusuar më shumti vetëm te ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës mësimore vetëm disa</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri për disa metoda të mësimdhënies, gjatë zhvillimit të orës mësimore përdor ndonjë metodë apo teknika që nxit mendimin kritik, krijues të nxënësit, por vetëm disa nxënësve u jep</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për shumëllojshërinë e metodave të mësimdhënies, gjatë zhvillimit të orës mësimore përdor metoda dhe teknika që nxisin mendimin kritik, krijues të nxënësit, që nxisin</i>
---	---	--	---	--

	<i>më shumti te të mësuarit mekanik e riprodhues dhe nuk nxiten shprehitë e të menduarit në mënyrë kritike.</i>	<i>nxënësve u jep mundësi të diskutojnë apo të demonstrojnë shprehitë e mendimit kritik.</i>	<i>mundësi të diskutojnë në këto metoda.</i>	<i>diskutimin (apo debatin) dhe i jep mundësi të gjithë nxënësve të përfshihen në këto metoda.</i>
Mësuesi drejton pyetje të niveleve dhe llojeve të ndryshme dhe nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit.	<i>Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve dhe niveleve të ndryshme Gjithashtu pyetjet i drejton vetëm mësuesi dhe nuk nxit nxënësit të bëjnë pyetje..</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve të ndryshme dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit por nuk i jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai përdor lloje të kufizuara pyetjesh dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit por nuk i jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai i përdor këto gjatë gjithë orës mësimore dhe gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit dhe njëri – tjetrit.</i>
Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve (6 pikë)				
	<i>Mësuesi përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e tij në</i>	<i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur</i>	<i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur</i>	<i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur</i>

Mësuesi vlerëson për të identifikuar nevojat për përmirësim të nxënësit dhe lehtëson procesin e nxënies së tij duke përdorur teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit, sipas niveleve të arritjes.	<i>orën e mësimit. Mësuesi përdor disa teknika vlerësimi, por nuk përdor nivelet e arritjes për të vlerësuar përmbushjen e rezultateve të nxënësit të orës mësimore.</i>	<i>informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit. Mësuesi përdor vlerësimin nxënësit për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimit. Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi, bazuar në rezultatet e nxënësit të orës mësimore dhe në nivelet e arritjes.</i>	<i>informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit Ai përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimit duke identifikuar nevojat për përmirësim të tij. Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi, bazuar në rezultatet e nxënësit të orës mësimore dhe në nivelet e arritjes.</i>	<i>informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit Ai përdor vlerësimin për të identifikuar pikat e forta të tij si dhe nevojat për përmirësim të nxënësit duke e mbështetur dhe lehtësuar në procesin e nxënies së nxënësit. Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit, sipas niveleve të arritjes mbështetur në rezultatet e nxënësit të orës mësimore.</i>
	<i>Mësuesi jep detyra për të gjithë nxënësit</i>	<i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e</i>	<i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e</i>	<i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e</i>

detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënësve dhe nevojave të nxënësve.	<i>nxënësve, pa marrë parasysh stilet e të nxënësve apo nevojat e nxënësve.</i>	<i>nxënësve, angazhon vetëm disa nxënës me detyra të diferencuara.</i>	<i>nxënësve, angazhon nxënësit me detyra të diferencuara bazuar në nevojat e tyre.</i>	<i>dhe angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënësve dhe nevojave të tyre.</i>
--	---	--	--	---

Përdorimi i mjeteve didaktike dhe digjitale (6 pikë)

Mësuesi përdor mjetet mësimore didaktike për temën mësimore	<i>Mësuesi nuk përdor mjete mësimore didaktike për arritjen e rezultateve të të nxënësve të temës mësimore.</i>	<i>Mësuesi përdor vetëm mjetet mësimore didaktike, të cilat janë të kufizuara për zhvillimin e plotë të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore.</i>	<i>Mësuesi përdor vetëm mjetet mësimore didaktike të përshtatshme në përmbytje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore, por nuk angazhon shumë nxënës në përdorimin e tyre.</i>	<i>Mësuesi ka krijuar mjete mësimore didaktike dhe i përdor ato në përmbytje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore duke vënë edhe nxënësit në përdorim të tyre në mënyrë që të nxënë te nxënësit të mësuarin praktik dhe krijues.</i>
Mësuesi përdor mjete digjitale për të zhvilluar	<i>Mësuesi nuk përdor mjete digjitale në përmbytje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore.</i>	<i>Mësuesi përdor me ndihmën e të tjerëve mjete digjitale por përmbytja nuk lidhet shumë me rezultatet e të</i>	<i>Mësuesi përdor vetëm mjete digjitale në përmbytje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore, por nxënësit nuk angazhohen në</i>	<i>Mësuesi përdor mjete digjitale dhe angazhon nxënësit në kryerjen e veprimtarive që kërkojnë përdorimin e TIK- ut, në përmbytje</i>


aftësitë digjitale të nxënësve		<i>nxënërit të temës mësimore.</i>	<i>përdorimin e TIK-ut.</i>	<i>të rezultateve të të nxënërit të temës mësimore dhe për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.</i>
---------------------------------------	--	------------------------------------	-----------------------------	---

Përmbajtja e programit orientues për projektin kurrikular

Projektet kurrikulare kërkojnë që nxënësit të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin mësimor. Ata bëhen nxënës aktivë që marrin pronësinë e arsimimit të tyre, kryejnë kërkime, analizojnë të dhënat dhe zbatojnë njohuritë e tyre në situata të botës reale. Nxënësit mund të shohin rëndësinë dhe praktikitetin e asaj që po mësojnë ndërsa trajtojnë problemet nga jeta praktike, eksplorojnë tema me interes personal ose adresojnë çështje të komunitetit.

Projektet kurrikulare përfshijnë integrimin e njohurive dhe aftësive nga fusha të shumta lëndore, duke i lejuar nxënësit të krijojnë lidhje dhe të shohin ndërlidhjen e disiplinave të ndryshme. Në projekte, nxënësit punojnë në ekipe, duke ndarë idetë, perspektivat dhe ekspertizën. Ata angazhohen në aftësi të të menduarit të nivelit më të lartë, të tilla si aplikimi i njohurive, sintetizimi i informacionit dhe marrja e vendimeve. Kjo promovon zhvillimin kognitiv dhe përgatit nxënësit për sfida përtej klasës.

- Projekti kurrikular shtrihet përgjatë gjithë vitit shkollor, pra në të tri periudhat.
- Mësuesi që kur planifikon projektin duhet të ketë në vëmendje vlerësimin e tij. Vlerësimi nuk është diçka që ndodh vetëm në fund të projektit, mësuesi vlerëson nxënësit dhe përgjatë zhvillimit të tij.
- Planifikimi dhe zbatimi në mënyrë efikase i një projekti kërkon që mësuesi të përcaktojë qartë detyrën mësimore në detaje për çdo grup dhe nxënës (është mjaft e rëndësishme që secili nxënës të jetë i përfshirë dhe i angazhuar me detyra të përcaktuara); të paraqesë rezultatet e të nxënërit që do të arrihen nëpërmjet projektit; të paraqesë hollësisht çdo fazë të realizimit të projektit; të qartësojë nxënësit për arritjen përfundimtare të projektit; të qartësojë nxënësit për kriteret e vlerësimit të projektit; të vëzhgojë dhe të japë gjykimin e tij në mënyrë të



vazhdueshme për ecurinë e zbatimit të projektit.

- Për procesin e kualifikimit mësuesi organizon prezantimin e produkteve të nxënësve gjatë zhvillimit të projektit kurrikular.

Statet kryesore që ndiqen për realizimin e projektit kurrikular janë:

- Përcaktohet çështja ose problemi për të cilin do të hulumtohet, në mënyrë që të jetë i menaxhueshëm në kohë.
- Përcaktohen detyrat që duhet të realizohen për të grumbulluar të dhënat e nevojshme nga puna e secilit nxënës.
- Grumbullohet materiali dhe/ose mjetet e nevojshme.
- Përpunohen dhe analizohen të dhënat e grumbulluara.
- Nxirren përfundime dhe përgjithësime nga të dhënat e grumbulluara dhe përgatitet produkti përfundimtar.
- Prezantohen gjetjet dhe përfundimet e projektit ose prezantohet produkti i krijuar.

Modele të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU dhe AML

A) Model 1 i një projekti kurrikular për nxënësit

PROJEKT KURRIKULAR

KLASA III ^A

Titulli i projektit: “Për një qytet më të pastër”

Ky projekt kurrikular është konceptuar si integrim midis lëndëve:

- *Gjuhë shqipe III* – Vënia në skenë e teatrit me titull “Qyteti im”
- *Dituri natyre III*-Riciklimi i mbetjeve
- *Edukatë shoqërore III* – Rregulla të edukimit qytetar
- *Aftësim teknologjik* – Përgatitja e ekspozitës me materiale të riciklueshme.
- *Veprimtari jashtë kurrikulare* – Merremi me kopshtari

Qëllimi i projektit është të përforcojë të mësuarit nëpërmjet aktiviteteve praktike duke bërë lidhjen logjike ndërmjet disiplinave të ndryshme. T’u japë nxënësve kënaqësinë e punës së përbashkët të mbështetur mbi njohuritë e tyre duke e shfaqur atë para prindërve dhe komunitetit.

Rezultatet e të nxënësve

- Lidh kurrikulën me eksperiencat e përditshme duke kontribuar në formimin e tyre si qytetarë.
- Nxiti ndërgjegjen qytetare duke i bërë më të ndjeshëm kundrejt çështjeve që kanë të bëjnë me mjedisin dhe mbrojtjen e tij.
- Interpreton bukur i veshur në rolin e caktuar.
- Aftëson nxënësit në aftësi praktike në funksion të temës duke realizuar punë me materiale të riciklueshme apo kopshtari.
- Nxiti tek nxënësi dëshirën dhe kënaqësinë për bashkëpunim të ngushtë me njëri tjetrin dhe për të marrë pjesë në projekte të tjera.

- Integron fëmijën me nevoja të veçanta (fëmija me AK, autizëm jo verbale ndjek PEI e shoqëruar me mësuesen ndihmëse) duke rritur pavarësinë personale.

Ecuria metodike e projektit

Puna me projektin do të kalojë në tri faza

1. Faza e parë

- Zgjedhja e temës “Për një qytet më të pastër”
- Përcaktimi i kohëzgjatjes
- Realizimi i projektit do shtrihet për një periudhë dy mujore.
- Përcaktohen partnerët të cilët janë: nxënësit, mësuesit dhe prindërit.
- Përcaktohen teknikat dhe metodat brenda secilës lëndë.
- Përcaktohen detyrat për secilin grup nxënësish.

a) Gjuhë shqipe: Interpretimi i roleve në skenë.

b) Dituri natyre: Grumbullimi i njohurive të marra rreth materialeve dhe riciklimit të tyre.

c) Edukatë shoqërore: Bashkëbisedim rreth problemeve të ndotjes në komunitetin dhe qytetin ku jetojnë duke u dhënë alternativa zgjidhjesh nga nxënësit.

Fëmija me AK (jo verbal) do të shprehet nëpërmjet përdorimit të figurave.

d) Aftësim teknologjik: Përgatitja e kostumeve të personazheve me materiale të riciklueshme. Fëmija me AK do të ndihmojë në përgatitjen e kostumeve, përpunimin dhe ngjitjen e materialeve të riciklueshme me qëllim progresin në motorikën fine dhe pavarësinë e fëmijës.

e) Veprimtari jashtë kurrikulare: Merremi me kopshtari. Pastrimi i kopshtit të shkollës dhe ambientet përreth shkollës, kujdesi për pemët e lulet dhe mbjellje e pemëve dhe luleve të reja. Në këtë veprimtari fëmija me AK do të jetë përgjegjëse për ujiten e luleve të shkollës çdo ditë.

Produkti përfundimtar i këtij projekti do të jetë një album me fotografi që do të paraqesin momentet e punës së nxënësve për çdo hap projektit.

2. Faza e dytë

Zhvillohen veprimtari konkrete për secilën lëndë duke bërë lidhjen logjike midis tyre.

Ndarja e roleve dhe përgatitja e skenarit dhe përgatitja për pjesën; grumbullimi i informacioneve të sjella nga secili grup rreth materialeve të riciklueshme organizimi dhe diskutimi i tyre; biseda rreth problematikës së ndotjes të vëzhguara nga vetë nxënësit; përgatitja e posterave me mesazhe sensibilizuese dhe afishimi i tyre në ambientin ku do të zhvillohet shfaqja dhe jashtë ambienteve të shkollës si dhe përgatitja e kostumeve të fëmijëve me materialet e riciklueshme.

Fëmijët do të realizojnë disa orë pastrimi në ambientet brenda dhe jashtë shkollës si dhe në rrugët dhe rrugicat pranë godinës së shkollës.

Fëmija me AK do të ketë detyra në grupin në të cilin do të vendoset duke u përfshirë në çdo lëndë. Përfshirja në komunikim do të jetë nëpërmjet komunikimit me piktograma ndërsa në lëndët si Aftësim tekologjik dhe Veprimtari jashtë kurrikulare do të përfshihet më tepër në fushën e motorikës fine dhe autonomisë duke realizuar detyra praktike si përpunimi dhe ngjitja e materialeve të riciklueshme, si dhe ujitja e luleve në oborrin e shkollës.

3. Faza e tretë

Organizimi i shfaqjes dhe vënia në skenë e saj.

Vlerësimi i punës së secilit nxënës për përfshirjen e tyre në projekt.

Realizimi i albumit me foto si produkt i projektit të kryer.

Ndikimi që pati në komunitet ky projekt (marrja e feedback nga komuniteti në përfundim të projektit)

Shpenzimet financiare të projektit do të mbulohen nga kontributet e komunitetit.

B) Model 2 i një projekti kurrikular për nxënësit

Projekt kurrikular

Titulli: 21 mars “Dita ndërkombëtare e personave me sindromën down”

Lëndët të cilat lidhen me projektin:

- *Gjuhë shqipe*
- *Matematikë*
- *Qytetari*
- *Edukim figurativ*
- *Aftësim teknologjik*
- *Edukim muzikor*
- *Edukim fizik*

Rezultatet e pritshme:

Të gjithë nxënësit e klasës:

- Njohin parimet e gjithëpërfshirjes;
- Realizojnë aplikacione të ndryshme, për ditën e sindromës DOWN;
- Nxisin vlerën e pranimit të çdo personi në grup;
- Bashkëpunojnë për të organizuar dhe festuar një festë të përbashkët;
- Shkruajnë kartolina për shokun special;
- Mësojnë dhe këndojnë këngë të ndryshme

Pjesëmarrës në projekt:

- *Mësuesja kujdestare;*
- *Mësuesja ndihmëse,*
- *Prindërit,*
- *Punonjësit e shërbimit psiko-social në shkollë*

➤ Nxënësit e një klase në të cilën ka dhe fëmijë me sindromën down

Përmbledhje për veprimtaritë kryesore te projektit

Nr	Veprimtaria	Afati	Përgjegjësi
1.	Njohja me sindromën Down	Java 1	Mësuesja kujdestare me nxënësit, Mësuesja ndihmëse
2.	Takim me punonjësit e shërbimit psiko-social	Java I	Mësuesja kujdestare Nxënësit, Punonjësit e shërbimit psiko-social
3.	Mbledhja e materialeve për kartolinat	Java I	Mësuesja kujdestare Nxënësit, , Mësuesja ndihmëse
4.	Njohja me tekstet e këngëve të ndryshme për fëmijë	Java I	Mësuesja, të gjithë nxënësit
5.	Mësojnë këngën, përgatitja e kartolinave me urime	Java II	Mësuesja kujdestare, Mësuesja ndihmëse, Nxënësit
6.	Përgatitja e vizatimeve të ndryshme	Java II	Mësuesja, Nxënësit, Nxënësi me aftësi të kufizuara
7.	Prezantimi i projektit përfundimtar	Java II	Mësuesja kujdestare me nxënësit, prindërit

Mjetet: Lapsa me ngjyra, kartolina të ndryshme, letra muri dhe A4, ngjitës etj.

FAZAT KRYESORE TE ZBATIMIT TE PROJEKTIT

1. *Faza e parë e projektit:*

- ✓ Njohja e nxënësve me temën e projektit, kohëzgjatjen dhe pjesëmarrësit e tjerë të projektit.
- ✓ Merren mendimet e para nga nxënësit për informacionet që ata kanë për sindromën down, ditën ndërkombëtare të personave me sindromën down, etj.
- ✓ Diskutim dhe ndarja e opinionit të nxënësve rreth përvojave të tyre për bashkëjetesën në klasë me një nxënës me sindromën down.
- ✓ Krijohet një listë me pyetjet që janë ngritur nga nxënësit.

2. *Faza e dytë e projektit:*

Në këtë fazë zhvillohen veprimtari të ndryshme.

- ✓ Zhvillohet takimi me punonjësit e shërbimit psiko-social të shkollës (të cilët do të informojnë të gjithë nxënësit për karakteristikat kryesore psikologjike të personave me sindromën down)
- ✓ Zhvillohen takime me mësuesen ndihmëse për tu informuar më shumë rreth karakteristikave të nxënësve me sindromën down).

Veprimtaritë sipas fushave:

- Gjuhe shqipe: *Nxënësit do të shkruajnë mendimet e tyre për përvojën e të pasurit një nxënës me nevoja të veçanta në klasën e tyre.*
- Edukim figurativ: *Nxënësit do të realizojnë kartolina, vizatime për ditën ndërkombëtare të personave me sindromën down.*
- Edukim muzikor: *Nxënësit do të mësojnë të këndojnë këngë të ndryshme për fëmijë.*
- Matematikë: *Nxënësit do të mësojnë të kryejnë veprime të ndryshme me numrat, me pjesëmarrjen edhe të nxënësve me aftësi të veçanta.*
- Edukim fizik: *Nxënësit do të përfshihen në lojëra e ushtrime fizike të ndryshme.*

3. Faza e tretë e projektit:

- ✓ Në këtë fazë nxënësit bëjnë prezantimin e punës së tyre.
- ✓ Ftohen të marrin pjesë edhe pjesëtarët e tjerë të projektit: si p.sh. prindërit , punonjësit e shërbimit psiko-social, etj.
- ✓ Çdo nxënës lexon mendimin e tij të shkruar në kartolinë. Të gjithë nxënësit këndojnë këngët e mësuara gjatë zhvillimit të projektit.
- ✓ Së fundi diskutohet mbi rëndësinë dhe arritjet e projektit.

Burimet kryesore të informacionit

- 1) Tekstet mësimore të klasës.
- 2) Materiale të ndryshme jashtë kurrikulare, informacione nga interneti për ditën e sindromës down, dhe për personat me këtë sindromë.
- 3) Biseda me punonjësit psiko-social, mësues ndihmës dhe prindër të fëmijëve me sindromën down.
- 4) Materiale vizive (imazhe, video) të cilat lidhen me temën e projektit.

Produkti i pritshëm i projektit

- ✓ Nxënësit kryejnë punime artistike të gjithë bashkë
- ✓ Nxënësit festojnë të gjithë së bashku

Tematika e orëve të planifikuara në planin mësimor

- 1) Ndarja e detyrave për secilin nxënës, së bashku me literaturën e rekomanduar mësimore.
- 2) Marrja e informacionit lidhur me ditën ndërkombëtare të personave me sindromën down
- 3) Diskutimi në klasë i gjetjeve dhe rezultateve kryesore të arritura nga nxënësit.
- 4) Përzgjedhja e rezultateve kryesore për raportin përfundimtar.
- 5) Prezantimi i produktit përfundimtar

Mënyra e vlerësimit të nxënësve

- 1) Shkëmbimin e ideve, bashkëpunimin, iniciativën, reagimet emocionale dhe psikomotore, punimet e krijuara gjatë projektit, pavarësinë e nxënësve në veprimtari.
- 2) Në TIK – realizimi i punimeve , kartolinave dhe materialeve të tjera
- 3) Bashkëpunimi, stimulohet ndërveprimi ndërmjet të gjithë nxënësve.
- 4) Motivohet nxënësi me sindromën down për arritjet e tij në bazë të planit edukativ individual (PEI).

Kriteret e vlerësimit të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU dhe AML

Model instrument i vlerësimit të projektit kurrikular

Kriteret për vlerësimin e projektit kurrikular vjetor				
Gjithsej 40 pikë				
Kriteret e vlerësimit	Niveli 1 – Dobët	Niveli 2 – Mjaftueshëm	Niveli 3 – Mirë	Niveli 4 – Shumë mirë
	0-2 pikë	3-6 pikë	7-9 pikë	10-12 pikë
Aftësitë kërkimore/hulumtuese. Demonstrimi i tyre (12 pikë)	Nxënësit rrallëherë përqendrohen te detyra e tyre. Ata mbledhin informacione pa gjetur zgjidhje të përshtatshme. Nxënësit përdorin një burim për të gjetur informacione.	Nxënësit dalin jashtë temës dhe nuk përqendrohen vetëm te detyra e tyre. Ata mbledhin informacion dhe gjejnë zgjidhje me ndihmë. Nxënësit përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione.	Nxënësit përqendrohen te detyra e tyre shumicën e kohës. Ara mbledhin informacion dhe gjejnë zgjidhje standarde. Nxënësit përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione.	Nxënësit përqendrohen te detyra e tyre. Ata orientohen dhe vetëdrejtohen shumë mirë. Nxënësit mbledhin informacion në mënyrë aktive dhe komentojnë për të zgjidhur probleme. Nxënësit përdorin shumëllojshmëri informacionesh.
Analiza dhe interpretimi i të dhënave,	0-2 pikë Nxënësit rrallëherë	3-5 pikë Nxënësit ndonjëherë	6-8 pikë Nxënësit zakonisht	9-10 pikë Nxënësit përdorin gjatë gjithë

fakteve, ngjarjeve etj. Zgjedhja dhe zbatimi i teknikave të përshtatshme (10 pikë)	<i>përdorin teknika të përshtatshme. Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban shumë gabime.</i>	<i>përdorin teknika të përshtatshme, por jo në mënyrë të vazhdueshme. Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban disa gabime të rëndësishme.</i>	<i>përdorin teknika të përshtatshme dhe efektive. Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban pak gabime.</i>	<i>projektit teknika të përshtatshme dhe efektive. Analiza, interpretimi, zgjidhja nuk përmban gabime.</i>
Aftësitë e prezantimit: Prezanton në mënyrë efektive rezultatet e projektit (18 pikë)	0-5 pikë <i>Në prezantimin e nxënësve materiali është i çorganizuar dhe rrëmujë. Është e vështirë të kuptosh cilat informacione shkojnë me njëri -tjetrin. Prezantohen shumë pak rezultate të projektit.</i>	6 -9 pikë <i>Në prezantimin e tyre, nxënësit organizojnë mirë punën e tyre. Prezantimi jo gjithmonë të krijon lehtësi dëgjimi dhe të kuptuari. Prezantohen vetëm disa rezultate të projektit.</i>	10-14 pikë <i>Në prezantimin e tyre nxënësit organizojnë mirë punën e tyre që në shumicën e kohës të krijon lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari. Në përgjithësi prezantohen rezultatet e projektit.</i>	15-18 pikë <i>Në prezantimin e tyre, nxënësit organizojnë shumë mirë punën e tyre që të krijon lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari. Rezultatet e projektit prezantohen qartë.</i>



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Rruga "Naim Frashëri"

Nr. 37

Tiranë

Shqipëri

www.ascap.edu.al

sekretaria@ascap.edu.al

